



CIKLI I DEBATEVE

Risi për rrjetin alumni

Një format i ri aktivitetesh dhe diskutimesh u ofrohet këtë vit anëtarëve të rrjetit alumni të shkollës. Organizimi i ciklit të debateve të alumnëve, një takim periodik përmujor, synon që të nxisë një frymë diskutimesh konstruktive mbi temat e aktualitetit politik dhe shoqëror të vendit. Duke sjellë çdo muaj në këto tryeza debati vendimmarrës të rëndësishëm dhe hartues të politikave publike, mundohet të krijohet terreni i duhur për bashkëpunimin dhe transmetimin e ndërsjelltë të ideve të reja. Nga njëra anë, alumnët pjesëmarrës të këtyre takimeve do të kenë mundësinë të sjellin idetë dhe sugjerimet e tyre për hartuesit e politikave të rëndësishme, por njëkohësisht, edhe vetë ata do të shërbejnë si përçues nga lart-poshtë të këtyre ideve tek shtresat e tjera të shoqërisë. Në këtë mënyrë, rrjeti alumni bëhet një promotor i mëtejshëm i zbatimit të reformave të rëndësishme integruese, të cilat kërkojnë mbi të gjitha edhe informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për të patur suksesin e pritsëm.

ORGANIZIMI I DEBATEVE

Ky organizim i ri do të nisë gjatë vitit 2015 me një kalendar të përcaktuar mbi disa reforma dhe tema të rëndësishme me të cilat përballet vendi. Është planifikuar që takimet të organizohen fillimisht me një periodicitet njëmuajor, përgjatë të enjtes së fundit të muajit, në formatin e një takimi në rregullat e "Chatham house". Ky rregull përcakton se pjesëmarrësit janë të lirë të përdorin informacionet e marra gjatë diskutimeve, por duke mos bërë pub-



TAKIME TË PËRMUAJSHME PËR TË DISKUTUAR MBI REFORMAT DHE TEMAT E AKTUALITETIT POLITIK

Cikli i debateve, një risi për rrjetin

like identitetin dhe lidhjen politike të autorit. Çdo debat, parashikohet që të ketë dy-tre të ftuar nga vendimmarrës të rëndësishëm si dhe një moderator, i cili do të përgatisë dhe prezantojë një përmbledhje të shkurtër të temës për të cilën do të diskutohet. Në përfundim të takimit, diskutimet dhe idetë e hedhura do të shërbejnë për të botuar një artikull

të shkurtër në një prej të përditshmeve kryesore të vendit. Nëpërmjet këtij publikimi synohet transmetimi i ideve dhe sugjerimeve tek grupet e ndryshme të interesit dhe publiku i gjerë.

TEMATIKAT E DEBATIT

Organizimi dhe mbështetja financiare e këtyre takimeve do të bëhet e mun-

Debatet e parashikuara për vitin 2015

Debati i parë, Prill – Reforma në Drejtësi

Diskutim mbi projektin e reformimit të sistemit të drejtësisë. Cila është situata dhe sugjerimet e deritanishme të profesionistëve për komisionin e posaçëm parlamentar.

Debati i dytë, Maj - Luftëtarët shqiptarë të ISIS

Përse luftojnë shqiptarët nën flamurin e ISIS ? Rreziku i ekstremizmit fetar dhe masat e marra për të penguar rekrutimet e mëtejshme.

Debati i tretë, Maj - Hapja e dosjeve dhe lustracioni

A duhen bërë publike dosjet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit dhe a duhet shoqëruar ky proces me masa shtrënguese ndaj tyre për përfshirjen në administratë dhe strukturat gjyqësore ?

Debati i katërt, Qershor – Zgjedhjet vendore - Programet e kandidatëve

Çfarë premtojnë kandidatët për problemet kryesore të zhvillimit të Tiranës dhe disa prej qyteteve kryesore? Zbërthimi i programeve dhe premtimeve të tyre për të kuptuar më mirë se ç'përfaqësojnë.

Debati i pestë, Korrik – Turizmi dhe perspektivat e zhvillimit

Turizmi, si paraqitet situata e infrastruktur-



TIK E SHOQËROR

alumni

dur nëpërmjet Akademisë së Studimeve Politike si struktura përgjegjëse për zbatimin e programit të shkollës. Të gjithë alumnët janë të mirëpritur për t'u bërë pjesë e debateve, jo vetëm si pjesëmarrës, por edhe panelistë oponentë apo moderatorë të debatit. Kushdo që dëshiron të nxisë diskutimin dhe të sjellë idetë dhe sugjerimet e tij për

turës pritëse dhe hotelierisë në qytetet bregdetare. Çmimet dhe promocioni nga organet qendrore dhe ato vendore. Vlerësime dhe sugjerime.

Debati i gjashtë, Shtator - Prioritetet e zhvillimit ekonomik afatgjatë

Shanset e ekonomisë shqiptare për të qenë konkurruese përballë një bote gjithnjë e më globale. Cili do të jetë modeli ekonomik ku mund të mbështetet zhvillimin afatgjatë?

Debati i shtatë, Tetor – Axhenda e integritimit evropian

Ecuria përgjatë vitit 2015 e vendit tonë në zbatimin e prioriteteve drejt integritimit evropian. Diskutim mbi fazat e pritshme



Fotot nga takimi i dytë vjetor i rrjetit alumni

Foto e kopertinës nga inisiativa publike e organizuar nga pjesëmarrësit e Shkollës me temë "Sistemi i luftës ndaj korrupsionit në dogana"

vendimmarrësit, do të ketë mundësinë që të bëjë të dëgjohet zëri i tij tek të ftuarit në panel si dhe tek kolegët e tjerë të rrjetit alumni. ASP ka skicuar një kalendër paraprak të takimeve, i cili mund të ndryshohet pas propozimeve që mund të vijnë nga vetë alumnët, por edhe në përgjigje të aktualitetit dhe zhvillimeve të mundshme.

të reformave që duhen ndërmarrë.

Debati i tetë, Nëntor – Administrata vendore pas zgjedhjeve

Zbatimi i statusit të nëpunësit civil për administratën vendore. Verifikimi i problematikës dhe sugjerimet për të mos patur ndryshime të administratës lokale në bashkitë ku ka rotacion të drejtuesve.

Debati i nëntë, Dhjetor – Korrupsioni

Vëzhgim mbi rastet e korrupsionit të denoncuar dhe ecuria e tyre në shkallët e gjyqësorit. Vlerësime dhe sugjerimet e nevojshme për luftën ndaj korrupsionit.

Gjeneratat 2007-2014

Takimi i II vjetor i rrjetit alumni

Takimi i dytë vjetor i alumnëve të "Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike" u organizua më 26 Dhjetor 2014, në një atmosferë festive në mjediset e hotel "Tirana International". Mbi 80 ish-pjesëmarrës të këtij programi të viteve 2007 - 2014, si dhe lektorë dhe miq të tjerë të shkollës, u mbledhën së bashku në këtë fundvit me dëshirën për të gjeneruar ide të reja nga rrjeti i alumnëve.

Z. Erjon Tase, drejtori ekzekutiv i "Akademisë së Studimeve Politike", organizatës që zbaton programin e shkollës politike, analizoi ecurinë përgjatë vitit 2014 si dhe prezantoi inisiativat e reja për të fuqizuar më tej rrjetin alumni.

Z. Ledio Braho, si një nga pjesëmarrësit në Akademinë Rajonale për Demokraci, e organizuar nga ASP dhe shkollat e tjera të rajonit, ndau eksperiencën e tij në angazhimin në këtë program. Një moment i veçantë i ceremonisë ishte dhe pranimi në këtë familje të madhe të alumnëve i pjesëmarrësve të gjeneratës 2014, brezit që përfundoi programin njëvjeçar dhe do të certifikohet së shpejti. Vazhdimi i aktivitetit në formën e një koktejli shërbeu si një mundësi e mirë për alumnit e të gjeneratave të ndryshme për t'u njohur më mirë dhe shkëmbyer kontaktet e tyre.

Të angazhuar për të ndërtuar Evropën e së ardhmes

Seminari i parë i alumnëve të shkollave të studimeve politike u zhvillua në Strasburg në datat 19 – 20 Qershor 2014. Ky ishte event i parë i këtyre përmasave, i cili mbledhi së bashku mbi 40 alumnë nga 21 shkolla, që veprojnë nën ombrellën e Këshillit të Evropës në tre kontinente të ndryshme. Tematika e seminarit u fokusua tek diskutimi i ideve që mund të ndihmojnë në shfrytëzimin e potencialit të të rinjve për të ndërtuar Evropën e së ardhmes, temë kjo e lidhur edhe me diskutimet e pritshme në Forumin Botëror të Demokracisë, i organizuar nga datat 3-5 nëntor 2014.

Për të përcaktuar përfaqësuesit e rrjetit alumni, të cilët do të merrnin pjesë në këtë seminar, Akademia e Studimeve Politike ftoi 15 anëtarë të rrjetit (kryesisht ata që kishin një eksperiencë profesionale dhe angazhim me të rinjtë) për të shkruar një abstrakt me idetë e tyre mbi këto dy nëntema:

- Margjinalizimi i gjeneratave të sotme të të rinjve: A është thyer pakti mes gjeneratave?
- A mund të sjellin të rinjtë një set të përbashkët vlerash për të ardhmen? Bazuar mbi këto punime, por dhe kriterit të balancimit të përfaqësuesve të karrierave, angazhimeve dhe gjinive të ndryshme, u përzgjedhën për të qënë pjesë e këtij seminari ndërkombëtar alumnët Edlira Gjoni, Altin Hoti dhe Elira Çanga.

Më poshtë po publikojmë esetë e tyre mbi angazhimin e të rinjve për të ndërtuar Evropën e së ardhmes. Seminari i dytë i alumnëve në Strasburg pritet të mbahet sërish në Qershorin e ardhshëm.



ELIRA ÇANGA

Eksperte e medias pranë OSBE
(Alumni 2009)



“Të rinjtë, qytetarë aktivë apo të lënë pas dore?”

Ka një potencial të madh te të rinjtë e sotëm në të gjithë Evropën, të re dhe të vjetër. Po për fat të keq, të rinjtë përballen me kaq shumë vështirësi sa i përket arsimit, punësimit si dhe mundësive që kanë për të ecur përpara në karrierë. Në një kohë krize ekonomike dhe financiare, këto vështirësi shtohen. Si një shembull personal që e vë theksin te këto vështirësi, mund të përmend faktin se në klasën time të Masterit për Studime Europiane, vetëm tre në pesë profesionistë të rinj që kanë studiuar drejtësi, ekonomi apo media; punojnë aktualisht në fushat e tyre të ekspertizës. Kjo e redukton ndjeshëm mundësinë për të kontribuar me përvojën e tyre. Nëse kapacitetet e tyre do të mbështeten, nxiten dhe zhvillohen më tej, ky do të ishte një kontribut për të ardhmen e tyre, por edhe për angazhimin e mëtejshëm në shoqërinë civile dhe opinionin publik. Të rinjtë ndodhen tashmë në udhëkryq sa i përket pjesëmarrjes në jetën sociale, në Shqipëri dhe gjetkë. Kur strukturat sociale dobësohen, kjo ndihet mjaft nga të rinjtë; ata bëhen më të brishtë dhe të varur. Ndjesia e përgjegjësisë kolektive të të rinjve përkundrajt shoqërisë është shumë e rëndësishme dhe zhvillimi i

kësaj ndjesie është i domosdoshëm për paqen sociale. Sondazhet e fundit kanë treguar se mes të rinjve shqiptarë ka një ndjesi dorëzimi përballë klasës politike që jo se e pengon, por e shpërfill mendimin e tyre kritik lidhur me zhvillimin e komuniteteve.

Qytetarët e rinj janë të vetëdijshëm për faktin se ata janë pak të informuar apo të përfshirë në jetën publike lokale. Kjo e kthen në një sfidë qytetarinë aktive për të rinjtë shqiptarë. Kjo lloj qytetarie përfshin tre lloje të drejtash; civile, politike dhe sociale. Të drejtat sociale, mes të tjerash, përfshijnë edhe standardet minimale të sigurisë financiare që mundësojnë shtetasit të permbushin të drejtat e tyre politike dhe civile. Ndaj, puna e paguar dhe/ose burimet e të ardhurave janë thelbësore në këtë tranzicion të të rinjve drejt qytetarisë aktive.

Arsimim më i mirë, trajnim, mundësi punësimi, nxitje e angazhimit në debatet qytetare dhe mundësi për të ndikuar opinionin publik; a është kjo zgjidhja? Mundet të mos jetë e mjaftueshme dhe përfundimtare, por për momentin është forma më efektive për të kontribuar për një rini që merr pjesë aktivisht në vendimet qytetare për të ardhmen.



ALTIN HOTI

Zv.rektor i Universitetit Luarasi
(Alumni 2012)

“Të rinj të angazhuar mund të fitojnë përballjen e brezave”

Tensioni midis brezave është po aq i vjetër sa njerëzimi. Megjithatë, vitet e fundit kjo përplasje mes brezash është rritur ndjeshëm. Dinamizmi i rinisë, mundësitë për të patur më shumë njohuri dhe qasja në botën e informacionit, krijojnë natyrshëm përballjen mes pozicionit që rinia ka në një shoqëri për shkak të mungesës së eksperiencës jetësore dhe profesionale dhe mundësisë së saj për të kontribuar në zhvillimin shoqëror të vendit. Ky tension i krijuar mes të rinjve që dëshirojnë të marrin përgjegjësi të mëtejshme dhe brezit më të madh, i cili nuk ka besimin e duhur tek ata, krijon idenë e një rinie të frustruar dhe indiferente ndaj zhvillimeve të vendit. Në shoqëritë tona post-komuniste, përplasja mes brezave është edhe më e theksuar për shkak të vlerave morale dhe ideologjive me të cilat janë rritur gjeneratat e mëparshme. Zgjidhjen e kësaj situate e shikoj tek krijimi i disa vlerave të përbashkëta të të rinjve nëpërmjet edukimit në bankat e shkollës dhe universitete, duke krijuar një gjeneratë kritike dhe të angazhuar qytetare ndaj fenomeneve negative të shoqërisë sonë. Universitetet, si qendra të diturisë, kanë një rol të rëndësishëm për përfshirjen e të rinjve dhe amortizimin e konfliktit midis brezave. Nëpërmjet këtij aktivizimi të vazhdueshëm, rinia do të jetë e aftë që të sigurojë vendin e saj në shoqëri, por edhe të përballojë sfidat e së ardhmes.



EDLIRA GJONI

Koordinatorë e projektit EU-CARDS VET twinning / Gazetare
(Alumni 2008)

“Koha për t’u përballur me elitën e vjetër”

I ri, i arsimuar mirë, aktiv, energjik, plot ide, i angazhuar për të ndryshuar shoqërinë? Je i gatshëm për të dhënë kontributin tënd? Mundesh, por jo në Ballkan. Jo në Shqipëri. Detyra jote më e rëndësishme si anëtar i një partie politike do të jetë të marrësh pjesë në mitingje, të valëvisësh flamujtë apo edhe të sigurohesh të sjellësh sa më shumë familjarë në mitingje. Ndërkohë, ti je diplomuar në shkollat më të njohura të botës dhe je kthyer në Shqipëri për shkak se dëshiron të kontribuosh për një të ardhme më të mirë.

Problemi i vetëm është se liderët e vjetër të partive politike ndjehen të kënaqur në sistemin e tyre paternalist dhe oligarkik. Energjia dhe optimizmi yt është një “kërcënim” për shkollën e vjetër të përgjeshme të pushtet-ndarësve, prandaj, ti dhe pjesa tjetër e shoqërisë je i privuar nga këto vlera “shqetësuese” për klasën politike ekzistuese. Kjo është ajo që kam vërejtur si gazetare, por edhe pas angazhimit personal politik, ashtu si qendra të rinj të etur për t’u bashkuar dhe për të

kontribuar me idetë e tyre në hartimin e programeve dhe strategjive të ndërhyrjes në të gjithë sektorët.

Përrjashtimi i të rinjve nga proceset politike, përbën një rrezik për perspektivën e duhur afatgjatë të zhvillimit të vendit, shtysën e ndryshimit dhe shpërndarjen e drejtë të burimeve ndërmjet gjeneratave. Pengesat janë komplekse dhe sfidat janë të vështira, duke filluar nga rindërtimi i vetëbesimit në demokraci dhe reformimi i institucioneve, të cilat mund të hapin dyert për kontributin e të rinjve. Partitë politike dhe qeveria duhet t’i shohin të rinjtë si partnerë në hartimin e zgjidhjeve për problemet e përbashkëta. Rinia nuk është një rrezik, një problem apo një konkurrencë ndaj politikës së vjetër. Ajo duhet të vlerësohet si aktor social me aftësitë dhe kapacitetet për të sjellë zgjidhje konstruktive për problemet e vendit. Është koha për politikëbërësit dhe qeveritë për të ftuar të rinjtë në diskutimet e politikave të rëndësishme dhe t’i bëjnë ata pjesë aktive e proceseve vendimmarrëse.

NGJARJE

Trajnim për negociatat me BE-në, një mundësi e re certifikimi për alumnët



Akademia e Studimeve Politike organizoi në datat 22-23 Nëntor 2014 në Pogradec, kursin e parë kombëtar për alumnët e saj me temë "Proçesi i negociatave për integrimin në Bashkimin Evropian". Pas marrjes së statutit të vendit kandidat, procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka kaluar në një fazë të re, atë të negociatave të kapitujve të anëtarësimit. Përgatitja e duhur dhe eksperiencia e punonjësve të administratës shqiptare do të ndikojë drejtpërdrejt në ecurinë e këtij procesi mjaft të rëndësishëm për vendin tonë. Në këtë optikë u mendua që të zhvillohet edhe ky kurs dy ditor informimi, në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Të ftuar në këtë trajnim ishin alumni, të cilët janë aktualisht pjesë e administratës publike, por njëkohësisht edhe përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, të cilët do të caktohen në muajt e ardhshëm në strukturat negociatore shqiptare.

Tematikat e kursit u trajtuan nga zv.ministri i Integrimit z. Gentian Elezi; drejtori i ASPA z. Fatmir Demneri; zv.shëfja e Drejtorisë Politike të Delegacionit të BE-së në Tiranë, znj. Plamena Halacheva; anëtarja e zyrës së shefit të negociatave Kroaci-BE, znj. Dubravka Kobas Lucic; diplomati francez z. Hubert Petit dhe z. Alban Bala, ekspert i marrëdhënieve publike dhe negociatave.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësve iu dorëzua një certifikatë për pjesëmarrjen dhe angazhimin në këtë trajnim të rëndësishëm, e lëshuar në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Një format i ngjashëm trajnimi për alumnët synohet që të zhvillohet edhe në vitin 2015.

6 Përgatit brezin e ri të liderëve



Alumnët në Akademinë Rajonale për Demokraci

Programi i vitit të dytë të Akademisë Rajonale për Demokraci (RAD), me temë "Të drejtat e njeriut dhe minoritetëve në Ballkan" ishte një tjetër mundësi për angazhimin e alumnëve të shkollës në sferën rajonale. Ky angazhim i përbashkët i shtatë shkollave politike është një nga evenimentet më të rëndësishme rajonale, e cila mbledh së bashku çdo vit 50 udhëheqës të rinj nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Në përfundim të ciklit prej katër seminaresh të vitit 2014 patën mundësinë

të certifikoheshin nga kjo Akademi tre alumnë, më konkretisht Edlira Nasi, Ledio Braho dhe Rezart Xhelo. Gjithashtu, alumna Edlira Gjoni, ishte një tjetër kontribut i shtuar i programit në rolin e panelistes dhe moderatores në disa prej seminareve të këtij cikli. Angazhimi i tyre në diskutime dhe punë në grup, u vlerësua nga organizatorët e programit rajonal. Ndërkohë, në gjeneratën e vitit të tretë të RAD, nën temën e "Ndërtimi i institucioneve demokratike", janë përzgjedhur për të marrë pjesë alumnët Kjudjan Seferaj dhe Endri Mykaj.

Programi financohet nga Bashkimi Evropian dhe fondi "Balkan Trust for Democracy". Rrjeti i shtatë shkollave politike të Këshillit të Evropës në rajonin e Ballkanit siguron zbatimin e projektit në nivel vendor dhe koordinon bashkëpunimin rajonal. Ky program do të vazhdojë të kontribuojë për ndërtimin e një gjenerate të re udhëheqësish, të cilët do të kapërcejnë barrierat historike që ekzistojnë në Ballkan. Për më tepër detaje mbi programin dhe pjesëmarrësit, ju lutem të konsultoheni me faqen zyrtare të programit: www.radwb.eu

Rrjeti alumni i shkollës solidaritet për zonat e përmytura

Rrjeti i alumnëve të shkollës iu bashkua thirrjes për solidaritet ndaj zonave të përmytura në Jug të vendit në fillim të muajit shkurt 2015. Në vijim të inisiativës të ndërmarrë nga vetë antarët e këtij rrjeti, ASP u angazhua për të shtrirë më tej këtë kërkesë për kontribute dhe për të koordinuar dorëzimin e ndihmave. Vetëm gjatë një dite për mbledhjen e kontributeve të alumnëve, u arrit që të sigurohej një shumë prej 54 mijë lekësh, e cila në respekt të nevojave të Shtabit të Emergjencës, u vendos që të përdorej për blerjen e 100 dëngjeve me jonxhe si ushqim për bagëtitë e zonave të përmytura. Komisioni i alumnëve, falë edhe ndihmës dhe koordinimit të shpejtë të alumnit Florjan Muçaj, njëherazi nënkryetar i bashkisë Fier, dorëzoi zyrtarisht ndihmën pranë Prefektit të Fierit dhe kreut të Shtabit të Emergjencave të këtij qarku. Prefekti falenderoi rrjetin



alumni të shkollës dhe shprehu kërkesën për vazhdimin e ndihmave pasi zonat e përmytura do të vuajnë gjatë pasojat.

Një falenderim i veçantë shkon për kontribuesit: Anisa Xhafa, Lulzim Omuri, Pranvera Myrselaj, Florjan Muçaj Endri Mykaj, Vjollca Dako, Magi Apostoli, Rikelda Balliu, Juliana Cici, Amela Juka, Sofjan Jaupaj, Fabian Zhilla, Erlis Shahu, Admir Malaj, Erton Graceni, Dorina Puto,

Çfarë ka qënë për ju Shkolla e Studimeve Politike ?

Vlerësimet e disa prej alumnëve për programin e shkollës



OLS LAFE

Drejtor i Kabinetit pranë
Presidentit të Republikës

“Të jesh pjesë e një grupi individësh të fushave të ndryshme e të shkëmbesh ide dhe mendime për të tashmen e të ardhmen e shoqërisë shqiptare, e cilësoj si një eksperiencë unike. Pjesëmarrja në Shkollën Politike më ka mundësuar të njoh kolegë energjikë e të dedikuar në profesionet e tyre dhe kjo ka farkëtuar te unë mendimin që organizime të tilla janë ajo çka i duhet të gjithë brezave pjesë aktive ose jo e politikëbërjes në Shqipëri.”

GERTA META

Drejtoreshë ekzekutive, Shoqata për Kulturë
Demokratike, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

“Pjesëmarrja në programin e shkollës ka qënë teper interesante si nga tematikat e trajtuara ashtu dhe nga larmia e përfaqësimit të liderëve nga fusha të ndryshme. Koncepti i liderit, punës në grup dhe mirëfunksionimi i institucioneve publike, u ofruan tek ne me një qasje vërtetë europiane. Vlen të përmendet nga kjo eksperiencë akademike mënyra konkrete e njohjes të institucioneve të rëndësishme evropiane.”




LULZIM OMURI

Këshilltar i zgjedhur pranë
minibashkisë nr. 2 Tiranë

“Pjesëmarrja në programin e shkollës ishte një ndër eksperiencat më të bukura. Falë saj u njoha me të rinj të tjerë plot energji, të cilët punonin me përkushtim në pozicione të ndryshme, me dëshirën e madhe për ndërtimin e Shqipërisë evropiane. Nd-jehem krenar për dhënien e kësaj mundësie për të qënë pjesë e një rrjeti kaq të madh ekspertësh dhe politikëbërësish të rinj.”



ALUMNI NË FOKUS



JULIANA CICI

Zv.komisionere pranë
"Avokatit të Popullit"

"Kjo shkollë është një hap shumë i rëndësishëm në karrierën time. Përmes saj përfitova koncepte dhe këndvështrimin e duhur në nivel profesional mbi politikëbërjen në funksion të zhvillimit dhe integritit të shoqërisë sonë, këndvështrim, i cili shpesh mungon në realitetin politik shqiptar. Kontributi i kësaj shkolle është i domosdoshëm në krijimin e një lidheshi të ri politik dhe në funksion të së ardhmes evropiane të Shqipërisë."

FLORJAN MUÇAJ

Nënkryetar i Bashkisë Fier

"Duke gjykuar nga njohuritë e përfituara, mund të them pa frikë se sot e kuptoj më mirë realitetin politik në Shqipëri, rajon e më gjerë dhe e njoh më mirë vetveten. Kjo më ka bërë të kuptoj ndrojtjen, të cilën tashmë mund ta shndërroj në avantazh për të kapërcyer kufijtë. Shkëmbimi i përvojave dhe njohja nga afër me kolegë, të cilët jam i sigurt se do t'i shërbejnë për të mirë të ardhmes së vendit, ishin për mua një vlerë shtesë e marrë në këtë cikël studimor."



SOKOL BEGA

Ish-këshilltar politik vendas, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri / Monitorues, Misioni i Posaçëm Monitorues i OSBE-së në Ukrainë

"Krahas mundësisë për të përftuar dije në lëmin e politikës moderne, Shkolla e Studimeve Politike, përmes shkëmbimit të ideve me bashkëstudentë dhe ligjërues nga një mori fushash dhe pikëpamjesh, është një kalitje për një mendje të hapur dhe kureshtar. Po ashtu, është një portë tek një rrjet miqsh dhe bashkëpunuesish për sot dhe nesër."

ELVANA ZHEZHA

Drejtoresh e Qendrës Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim

“Të bëhesh pjesë e shkollës do të thotë të jesh pjesë e një rrjeti të gjerë profesionistësh, që duan të sjellin ndryshim në Shqipëri duke thelluar njohuritë e tyre dhe kuptueshmërinë e mënyrës se si politika duhet të vihet në funksion të zhvillimit të shoqërisë. Këto njohuri, të përcjella përmes lektorëve të zgjedhur me kujdes, ndikojnë në rritjen profesionale dhe në ushtrimin më të mirë të funksioneve drejtuese në administratë, biznes, etj.”



ERLIS HERENI

Këshilltar ligjor pranë Ministrisë të Brendshme

“Shkolla Politike është një ‘Pemë Suksesi’, frytet e së cilës ndër vite janë vjelë nga elita e menaxhmentit të politikës, biznesit dhe shoqërisë civile. Në një Shqipëri që progreson ngadalë drejt familjes evropiane, Shkolla Politike ia ka dalë të mbjellë kulturën evropiane në çdo institucion ku ajo përfaqësohet.”



DRITAN ÇEKANI

Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave

“Takimet dhe debatet në shkollën politike kanë qenë mënyra më e mirë për të diskutuar mbi pikëpamjet, idetë dhe mendimet tona. Një gjimnastikë e mendjes, e cila do të më mungojë tashmë. Ekspertët e zgjedhur dhe mënyra e organizimit të takimeve ishte ndër më të mirat, që personalisht kam përjetuar. Vlerësimet më të mira për një shkollë, që sot ka mirëfill stadin e një akademie të mendimit politik.”





KRESHNIK TERNOVA

Drejtor i Drejtorisë Rajonale
të Shëndetësisë, Fier

“Nuk ka rëndësi sa i talentuar je, sepse një ditë talenti yt do të lërë në baltë në qoftë se nuk je i aftë. Kur vendosa të ndiqja këtë shkollë kisha si qëllim për t’i çuar në një tjeër nivel aftësitë e mia në politikëbërje dhe vendimmarrje. Sot jam krenar që kam qenë pjesë e këtij programi kaq prestigjioz, i cili ka ndryshuar vizionin tim mbi politikën dhe më dha mundësinë e njohjes me njerëz të mrekullueshëm.”

LEDIO BRAHO

Partner Menaxhues
“BGK Legal & Tax Consulting”

“Shkolla e Studimeve Politike po aq sa është një institucion elitar për ndërthurjen e botëkuptimeve politike në Shqipëri, është edhe një pikë takimi midis të ndryshmëve që kanë vullnetin për të udhëhequr në politikë dhe jo vetëm. Angazhimi në programet rajonale të shkollës, më ka dhënë një mundësi të mëtijshme për të kontribuar në kapërcimin e pengesave që ekzistojnë në rajonin tonë.”



ENDRI MYKAJ

Këshilltar ligjor
pranë Kryeministrit

“Shkolla Politike ishte gjithnjë sfiduese duke na bërë të mendojmë në mënyrë analitike dhe kritike mbi çështjet me interes publik dhe duke na mësuar të komunikojmë idete tona në mënyrë inteligjente. Kurset më nxitën të eksploroj më tej interesat e mia në qeverisje dhe politikëbërje. Shkolla më dha dije, kontakte profesionale, miq të mirë dhe mbi të gjitha mundësinë për të qenë pjesë e një rrjeti të gjerë alumni.”





EVARIST BEQIRI

Kryetar i Degës Juridike
pranë Shërbimit Informativ Kombëtar

“Shkolla me formatin e saj të veçantë ishte një eksperiencë unike. Njohuritë e vlefshme dhe miqtë e çmuar, që fitova prej saj, përbëjnë një burim frymëzimi, në funksion të vetëpërmirësimit dhe forcimit të atyre parimeve demokratike që shkolla promovon”



KLEMENTINA CENKOLLARI

Gazetare e sektorit politik
pranë televizionit “Ora News”

“Ndjekja e kësaj shkolle ishte një mundësi e artë për të kuptuar se si ta përdorim potencialin tonë në praktikë. Përveçse një busull në të kuptuarit e politikës, pjesëmarrja na shërbeu për të orientuar vetveten; për të gjetur liderin që fshihet brenda nesh. Një përvojë e çmueshme, një përplotësuese e eksperiencës personale, besoj të gjithësecilit prej pjesëmarrësve.”



REZART XHELO

Ekspert i politikave dhe menaxhues
programesh pranë UN Women Shqipëri

“Shkolla është tashmë një mekanizëm vital i procesit politik. Ajo prezanton një dimension të ri të politikëbërjes përtej politikës dhe politikanëve. Një dimension ku marrëdhënia politike gërshetohet me atë personale e profesionale; aty ku debati politik mbështetet në kapacitetin profesional, një qasje unike për t’u përqaftuar nga politikanët e rinj dhe me gjerë.”



VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratiane
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar, gazeta Tema
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Specialist pranë stafit të Kryeministrit
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues
Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "World Vision"
Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Tershana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të Fëmijëve (UNICEF)
Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP

Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtorja e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM
Z. Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z. Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj. Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj. Sidita Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z. Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

Z. Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj. Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Znj. Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z. Erion Avllazagai	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z. Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"
Z. Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z. ERVIN KARAMUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj. EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
Z. FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave
Znj. GENTIANA RAMADANI	Drejtoresh ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"

VITI 2008

Znj. Arbana Dibra	Drejtoresh ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z. Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora News" TV
Znj. Beslinda Rrugja	Asistent avokate
Z. Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj. Brasena Koka	Koordinatorë projekti pranë organizatës "World Vision"
Znj. Brunilda Minarolli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj. Edlira Gjoni	Koordinatorë projektit EU-CARDS VET twinning / Gazetare
Znj. Edlira Mali	Drejtor Ekzekutiv e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj. Edlira Papavangjeli	Koordinatorë Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit
Znj. Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës

Z. GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z. GJOK VUKSANI	Deputet
Znj. IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes
Z. KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj. KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z. MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj. MONIKA STAFI	Gazetare "Top Channel"
Znj. NAHLEL BEJLERI - FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z. OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z. REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror
Z. REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj. SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere degë e "Opportunity Albania"

Znj. **VILMA PREMTI** Drejtore në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z. **Adrian SHEGA** Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë

Znj. **Admira Poci** Specialiste pranë Institutit Goethe

Znj. **Albana HANA** Specialiste në Ministrinë e Integritimit

Znj. **Ana XHEKA** Drejtore në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Znj. **Ardita SHEHAJ** Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës

Znj. **Beti NJUMA** Gazetare, "Top Channel"

Z. **Blerim KOLA** Kryeredaktor, Nesër TV

Z. **Edvin SHVARC** Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës

Znj. **Elira CANGA** Gazetare, "Gazeta Shqiptare"

Znj. **Elsa TOSKA (DOBJANI)** Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese

Znj. **Entela HAMITI** Anëtare e Partisë Socialiste

Znj. **Erinda SHAH** Anëtare e Partisë G99

Z. **Ermal GJINAJ** Kreu i departamentit të marrëdhënieve publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë

Z. **Eugen Pepa** Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar

Z. **Genc HOXHA** Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania

Z. **Gentian ISLAMI** Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë

Z. **Gentian MANO** Menaxher i organizatës "World Vision", Librazhd

Znj. **Gerta META** Drejtore Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)

Z. **Hysni AHMETAJ** Specialist në Ministrinë e Integritimit

Z. **Ilir TOPI** Aktivist i Forumit Rinor të Partisë Demokratike

Znj. **Ingrit PRIZRENI** Shtëpia Botuese "Media Print"

Znj. **Liliana ALIMETA** Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave

Znj. **Mimoza KOCIU** Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës

Z. **Plarent RUKA** Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë

Znj. **Plejada GUGASHI** Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania

Z. **Redi BADUNI** Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane

Z. **Redi SKENDERAJ** Gazetar, Koha TV

Znj. **Rezarta GODO** Programi "Brain Gain", PNUD

Znj. **Sonila MECO** Gazetare, Klan TV

Z. **Urim BAJRAMI** Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z. **Afrim Kola** Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare

Z. **Alban Fishka** Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror

Znj. **Aleksandra Bogdani** Kryeredaktore në "Top News" TV

Znj. **Anila Shqypi** Koordinatorë projekti, GTZ Albania

Z. **Arber Kadia** Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë

Z. **Besjan Pasha** Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI

Z. **Bilbil Keraj** Shef i kabinetit në Bashkinë Kukës

Znj. **Blerta Gjermani** Kryeredaktore, ORA News TV

Z. **Dritan Nushi** Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë

Znj. **Eglantina Bisha** Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"

Z. **Elton Lula** Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë

Znj. **Enina Mullaj** Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar

Z. **Enkes Shundi** Këshilltar, Shef i Protokollit të Presidentit të Republikës

Z. **Evarist Beqiri** Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror

Znj. **Fatjona Mejдини** Gazetare, "Shqip"

Z. **Fjorel Como** Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës

Z. **Genard Kastrati** Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve

Znj. **Giomela Gjini** Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave

Z. **Ilir Paco** Gazetar "Top Channel"

Znj. **Irena Kita (Dimushi)** Specialiste ligjore në Bankën Credins

Znj. **Jonida Shehu** Gazetare në "Vizion Plus" TV

Znj. **Karolina Risto** Kryeredaktore e Vizion Plus TV

Znj. **Klodiana Thartori** Koordinatorë Programi "Save the Children"

Z. **Klodjan Seferaj** Këshilltar në Këshillin e Ministrave

Znj. **Klotilda Neziri** Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit

Z. **Ledio Milkani** Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë

Znj. **Migëna Muhaj** Koordinatorë në programin Swiss Partnerships in Health

Znj. **Migëna Nelaj** Drejtore për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH

Z. **Ols Lafe** Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Znj. **Oriana Arapi** Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit në Këshillin e Ministrave

Z. **Qemal Cejku** Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës

RRJETI ALUMNI 2007-2014

Znj. Rozana Celmeta Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave

Z. Saimir Shatku Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës

Znj. Suela Cela Specialiste në departamentin ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

VITI 2011

Znj. Ada Ramaj Ndhimëse e zv.ministrit të Brendshëm

Znj. Albana Veizi Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës

Z. Alvi Bajramaj Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT

Znj. Anxhela Andoni Aktiviste e Forumit të Gruas të Partinë Socialiste, rrethi Pogradec

Z. Arlind Lugji Specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive

Z. Arnold Hajro Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)

Znj. Daniela Mehmeti Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës

Znj. Enila Hasani Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme

Z. Enio Haxhimihali Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit

Znj. Erjola Muka Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë

Z. Genti Çani Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Z. Gentian Xhaxhiu Gazetar "Shijak TV"

Znj. Gresa MARTIRI Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë

Z. Helidon BELE Drejtor në Tirana Bank

Z. Ilir Stojku Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë

Znj. Klesta Hysi Koordinatore programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"

Z. Kreshnik Ter-nova Administrator, ALK Pharma sh.p.k.

Znj. Ledi Jahja-Muçaj Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri

Znj. Merita Mansaku-Meksi Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim

Znj. Mirjam Reçi Drejtore ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës

Znj. Olta Blaceri Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora News" TV

Z. Qamil Dika Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD

Znj. Rajmonda Lajthia Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2012

Znj. Albana Shtylla Shefe kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Znj. Alisa Demollari Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë

Z. Altin Hoti Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian

Z. Altin Ibro Jurist/ Celibashi Consulting shpk

Z. Andi Seferi Drejtues i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri

Znj. Anisa Seferaj Juriste/ Bashkia Tiranë

Znj. Ardita Kongjonaj Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit

Z. Arian Galdini Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi

Znj. Baisa Sefa Kërkuuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri

Z. Elidon Laze Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme

Z. Erlis Shahu Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Z. Ermal Simaku Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste

Z. Ermir Godaj Shërbimi i Përmbarimit, Ministria e Drejtësisë

Znj. Ervina Domi Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave

Znj. Eva Dauti Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive

Znj. Florensa Haxhi Koordinatore e strategjive në Këshillin e Ministrave

Z. Fredi Guga Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"

Z. Ilir Kondi Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)

Z. Ilir Korbi Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme

Z. Ilir Mimani Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Znj. Jorina Gjinari Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future

Z. Ledio Braho Jurist në Ministrinë e Integritimit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës

Znj. Margarita Kola Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca KuqeZi (AK)

Znj. Mariola Qesaraku Koordinatore projekti pranë Institutit për Demokraci dhe Meditim

Znj. Marsida Çela Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA

Znj. Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj. Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënies me Publikun në Postën Shqiptare
Z. Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z. Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj. Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj. Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z. Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj. Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile

Znj. Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
Z. Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj. Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritimit/Aktiviste në Partinë Socialiste
Z. Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj. Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z. Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
Z. Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Z. Dritan Cekani	Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste
Z. Elidon Lamani	Menaxher projektsh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës"/ Aktivist i shoqërisë civile
Z. Endri Mykaj	Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave
Znj. Enisa Halili	Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë
Z. Erlis Hereni	Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"
Z. Florjan Mucaj	Nënkryetar i Bashkisë Fier/ Aktivist i Partisë Socialiste
Z. Francesco Mucaj	Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste

VITI 2013

Znj. Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj. Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)
Z. Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z. Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z. Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj. Blerina Doracaj	Juriste në Agjensinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
Znj. Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj. Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj. Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca Kuqezë (AK)

Z. Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
Znj. Klementina Cenkollari	Gazetare, "Ora News" TV
Z. Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
Znj. Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj. Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj. Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana

Znj. Ina Metko	Juriste, Ministria e Integritimit Evropian
Z. Juel Jarani	Zv.rektor në Universitetin e Sporteve
Znj. Juliana Cici	Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"
Z. Lulzim Omuri	Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike
Znj. Magi Apostoli	Koordinatorë projekti pranë "Europartners Development"
Znj. Pranvera Myrselaj	Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"
Z. Redi Saliasi	Përgjegjes i PR dhe komunikimit pranë kompanisë "Crown Agents"
Znj. Rikelda Balliu	Koordinatorë e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave
Znj. Vjollca Dako	Drejtoreshë ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"

VITI 2014

Znj. Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
Znj. Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënies publike pranë GIZ Albania/ Aktiviste e partisë FRD
Znj. Arsela Gjonaj	Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit

* I referohet pozicionit të mbajtur gjatë periudhës së pjesëmarrjes në program

ASP AKADEMIJA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



E përmuajshmeja "Politika", një botim i ri për alumnët dhe miqtë e shkollës

Gjatë vitit që lamë pas mori jetë një tjetër iniciativë drejtuar ish-pjesëmarrësve të shkollës, përmbledhja elektronike "Politika". Ky botim i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me platformën www.bota.al synon të sjellë në gjuhën shqipe një përzgjedhje të artikujve dhe analizave elitare të mendimit botëror. Çdo muaj, buletini do të trajtojë një çështje apo zhvillim kryesor të rëndësishëm global, parë në optikën vizionare të liderëve politikëbërës dhe mendim-

tarëve më të njohur të momentit. Nëpërmjet kësaj përqsajeje të re ndaj ideve dhe argumentimeve prestigjioze, synohet që të nxitet një thellim i mëtejshëm i informimit dhe analizimit të ngjarjeve të aktualitetit politik dhe social mbarëbotëror. Buletini i përmuajshëm elektronik u drejtohet së pari të gjitha alumnëve dhe pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, por besojmë se do t'i shërbejë rritjes së njohurive të publikut të gjerë në mbarë trevat shqipfolëse.

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha botimet në versionin pdf. Skanoni këtë kod për më tej QR CODE



Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center, Tel/fax: +355 4 2272173
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, +355 4 4504788
Kati 4, Zyra 2 E-mail: info@asp.al
Tirane, Shqipëri Web: www.asp.al

- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Akademia Studimeve Politike
- Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike
finançohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra
e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si
edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Schweizerische Eidgenosse
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
**Zyra e Bashkëpunimit
Zviceran në Shqipëri**